



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KRYETARI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 01-060/01-000034439-1/26 dt. 30.06.2026
Mitrovicë

Raport Nga Takimi i Parë Publik i Kryetarit me Qytetarët për vitin 2026

Hyrje

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna dhe në zbatim të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna e Mitrovicës së Jugut ka organizuar Takimin e Parë Publik të Kryetarit të Komunës me qytetarët për vitin 2026.

Takimi është mbajtur me 30 qershor 2026, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 14:00. Ky takim përbën njërin nga dy takimet vjetore të detyrueshme me publikun dhe ka për qëllim forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Ecuria e Procesit të Takimit

Lajmërimi për mbajtjen e takimit është bërë me kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes sa më të gjerë të qytetarëve.

Njoftimi është publikuar:

- në ueb faqen zyrtare të Komunës, në të dy gjuhët zyrtare;
- në rrjetet sociale të Komunës (Facebook);
- në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike;
- në hyrje të objektit të Komunës;
- si dhe në portalet lokale informative.

Pas hartimit dhe protokollimit, ky raport do t'u përcillet drejtorive komunale për informim dhe veprim në përputhje me përgjegjësitë e tyre.







Metoda e konsultimit
Konsultime me shkrim në mënyrë elektronike
Publikimi në ueb faqe

Kohëzgjatja
15 ditë pune
15 ditë pune

Në takim morën pjesë gjithsej 49 qytetarë, përfshirë përfaqësues të lagjeve, administratore të vendbanimeve, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të interesuar, (3 përfaqësuesit e KFOR-it, prej të cilëve 2 nuk janë nënshkruar).

Përmbajtja e Takimit

Takimi kishte karakter informues dhe konsultues. Kryetari i Komunës i informoi qytetarët lidhur me:

- prioritetet qeverisëse;
- sfidat aktuale;
- planet për investime konkrete në periudhën e ardhshme.

1. Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë dëgjim publik, i organizuar në funksion të avancimit të shërbimeve për qytetarët gjatë mandatit tonë në ekzekutivin e Komunës së Mitrovicës. Organizimi i dëgjimeve publike është obligim ligjor që buron nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, sipas të cilit secili kryetar komune organizon së paku dy dëgjime publike në vit. Ky është dëgjimi i dytë publik i organizuar gjatë këtij viti. Në dëgjimin e parë nuk pati mundësi të prezantoheshin shumë aktivitete, pasi ai u mbajt në javën e parë të marrjes së mandatit. Gjatë këtij takimi do të prezantohen shkurtimisht angazhimet dhe rezultatet e gjashtëmujorit të parë të mandatit. Qëllimi kryesor i këtij dëgjimi mbetet dëgjimi i shqetësimeve, vërejtjeve dhe propozimeve të qytetarëve për përmirësimin e shërbimeve komunale.

2. Prioritetet

- Mbështetja e fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, përfshirë funksionalizimin e ekipit geriatrik.
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe mirëmbajtja e hapësirave publike.
- Investimet në sistemet e ujitjes dhe zhvillimin e bujqësisë.

- Furnizimi me ujë të pijshëm për zonat rurale.
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe rehabilitimi i hyrjeve të qytetit.
- Zhvillimi i rajonit të Shalës përmes një strategjie afatgjatë.
- Investimet në infrastrukturën sportive, kulturore dhe rekreative.
- Zhvillimi i agroturizmit, trashëgimisë kulturore dhe ekonomisë lokale.
- Menaxhimi i pronës publike, luftimi i uzurpimeve dhe largimi i reklamave pa leje.
- Forcimi i kontrollit në ndërtim, rritja e sigurisë publike dhe transparencës institucionale.
- Mbështetja e të rinjve përmes programeve të praktikës profesionale.

3. Zotimet e Kryetarit të Komunës

- Të plotësohen deri në fund të mandatit të gjitha nevojat për asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Të funksionalizohet dhe zgjerohet ekipi geriatrik për ofrimin e shërbimeve ndaj personave të moshuar.
- Të vazhdojnë investimet për shtimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra.
- Të realizohen projektet për zgjerimin e sistemeve të ujitjes dhe mbështetjen e fermerëve.
- Të përfundojnë projektet për furnizimin me ujë të pijshëm në zonat rurale.
- Të realizohen investimet infrastrukturore në rrugë, ura dhe hyrjet e qytetit.
- Të hartohet dhe zbatohet strategjia dhjetëvjeçare për zhvillimin e Shalës.
- Të rikthehet në funksion ish-Kinoja në Tunelin e Parë si hapësirë kulturore dhe publike.
- Të realizohen investime të reja në infrastrukturën sportive dhe objektet rekreative.
- Të vazhdojë mbështetja për personat me nevoja të veçanta dhe programet e praktikës profesionale për të rinjtë.
- Të luftohen uzurpimet, reklamat pa leje dhe shfrytëzimi i paligjshëm i pronës publike, pa përjashtime.
- Të forcohet kontrolli mbi ndërtimet dhe të instalohen sisteme të sigurisë në objektet komunale dhe hapësirat publike.
- Të vazhdojë bashkëpunimi me ministritë, ndërmarrjet publike dhe partnerët institucionalë për realizimin e projekteve zhvillimore.

Pyetje, Kërkesa dhe Diskutime nga Qytetarët

Afrim Behrami – qytetar (banor i lagjes “Lekë Dukagjini”),

Qytetari ngriti shqetësime lidhur me gjendjen në lagjen “Lekë Dukagjini”, duke theksuar problemet me ngushtësinë e rrugës dhe pengesat në qarkullim si pasojë e automjeteve të parkuara në mënyrë të parregullt. Ai kërkoi ndërhyrje për menaxhimin e parkingjeve dhe lirim të hapësirave publike. Gjithashtu, ngriti shqetësime për vendosjen e kontejnerëve të mbeturinave, duke theksuar se lokacionet aktuale krijojnë probleme me shpërndarjen e mbeturinave gjatë kushteve atmosferike jo të favorshme dhe kërkoi rishikimin e tyre. Ai përmendi edhe mungesën e një zgjidhjeje për largimin e automjeteve që pengojnë qarkullimin.

Përgjigjja – Kryetari i Komunës, z. Faton Peci

Kryetari falënderoi qytetarin për shqetësimet e ngritura dhe sqaroi se çështja e lokacioneve të kontejnerëve është duke u rishikuar nga komuna. Ai bëri të ditur se ndryshimi i tyre kërkon procedurë dhe koordinim institucional, ndërsa theksoi se synimi është gjetja e zgjidhjeve më funksionale për menaxhimin e mbeturinave. Lidhur me problemet e parkingjeve dhe pengesat në qarkullim, Kryetari njoftoi se drejtori i Inspektoratit do ta vizitojë lokacionin për të shqyrtuar situatën, ndërsa çështja e kontejnerëve do të trajtohet nga drejtoria përkatëse. Ai bëri të ditur se komuna po shqyrton edhe zgjidhje më moderne për menaxhimin e mbeturinave, përfshirë mundësinë e vendosjes së kontejnerëve gjysmë nëntokësorë dhe nëntokësorë. Sa i përket automjeteve të parkuara në kundërshtim me rregullat, Kryetari njoftoi se komuna ka siguruar kontraktor për tërheqjen e automjeteve dhe se ky mekanizëm pritet të fillojë funksionimin.

Destan Rifat Mmakolli – qytetar, banor i lagjes Shipol

Qytetari falënderoi për organizimin e takimit dhe ngriti disa shqetësime me interes për qytetarët. Ai kërkoi adresimin e problemit të qenve endacakë, duke vlerësuar si një çështje të rëndësishme për sigurinë publike dhe duke kërkuar ndërhyrje konkrete nga institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, ngriti çështjen e pastërtisë dhe mbrojtjes së mjedisit, duke vlerësuar punën e punëtorëve të mirëmbajtjes, por duke theksuar nevojën për larje periodike të rrugëve dhe për masa shtesë për përmirësimin e higjienës publike. Si çështje të tretë, qytetari ngriti problemin e furnizimit me ujë të pijshëm, duke theksuar nevojën për shfrytëzim më efikas të kapaciteteve ujore dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve për përmirësimin e furnizimit dhe uljen e kostos së shërbimit.

Përgjigjja – Kryetari i Komunës, z. Faton Peci

Kryetari falënderoi qytetarin për shqetësimet e ngritura dhe vlerësoi angazhimin e punëtorëve të Ndërmarrjes Publike “Uniteti” në mirëmbajtjen e pastërtisë publike. Ai theksoi se përmirësimi i gjendjes së pastërtisë kërkon jo vetëm angazhimin e institucioneve, por edhe urrejtjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë qytetare. Kryetari njoftoi se komuna ka filluar larjen dhe dezinfektimin e rrugëve dhe hapësirave publike, si dhe është duke zhvilluar procedurat për dezinfektimin e zonave problematike pranë lumenjve dhe hapësirave me ujëra të ndenjura. Lidhur me qentë endacakë, Kryetari theksoi se kjo është një ndër shqetësimet kryesore të komunës dhe njoftoi se kanë përfunduar procedurat për kontraktimin e operatorit për trajtimin e tyre. Ai bëri të ditur se zbatimi i kontratës do të monitorohet dhe do të kërkohet përgjegjësi për rezultatet e arritura, në përputhje me legjislacionin dhe standardet profesionale. Në fund, Kryetari theksoi përkushtimin e komunës për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike, sigurisë së qytetarëve dhe adresimin e kërkesave të ngritura.

Qytetari Fadil Ademi, përfaqësues i fshatit Rashan,

Përshëndeti Kryetarin dhe të pranishmit, duke i uruar suksese në detyrë. Ai theksoi se fshati Rashan është një nga fshatrat që ka mbetur më i pazhvilluar në aspektin e infrastrukturës dhe se, për shumë vite, nuk ka përfituar investimet e nevojshme. Ai kërkoi të informohet për planet dhe projektet që komuna ka paraparë për këtë fshat, veçanërisht në fushën e infrastrukturës rrugore dhe furnizimit me ujë të pijshëm. Gjithashtu, ai vlerësoi qasjen e Kryetarit ndaj qytetarëve, duke shprehur shpresën se komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e fshatrave do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Përgjigjja – Kryetari i Komunës, z. Faton Peci

Kryetari falënderoi z. Fadil Ademi për pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar për zhvillimin e fshatit Rashan. Ai theksoi se Rashani ndër vite ka qenë një nga lokalitetet më të anashkaluara sa i përket investimeve infrastrukturore, gjë që ka ndikuar edhe në largimin e banorëve. Për këtë arsye, Kryetari bëri të ditur se zhvillimi i këtij lokaliteti do të jetë një nga prioritetet e komunës gjatë këtij mandati. Ai njoftoi se gjatë këtij viti janë planifikuar investime në infrastrukturën rrugore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në Rashan, me qëllim krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për banorët dhe nxitjen e zhvillimit të zonës. Lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm, Kryetari bëri të ditur se faza e parë e projektit është nënshkruar me Ministrinë përkatëse dhe do të implementohet nga Ndërmarrja Rajonale e Ujësjellësit. Ai shtoi se faza e dytë e projektit do të përfshijë shtrirjen e furnizimit në trasenë Mazhiq–Tërstenë–Rashan, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë për banorët. Në fund, ai theksoi se investimet në rrugë dhe ujësjellës do të ndikojnë në zhvillimin afatgjatë të fshatit Rashan dhe përmirësimin e kushteve për banorët.

Përfaqësuesi i këshillave lokale ngriti çështjen e mungesës së komunikimit të drejtpërdrejtë me Kryetarin e Komunës gjatë muajve të fundit. Ai bëri të ditur se më 17.03.2026 është dorëzuar kërkesë zyrtare për takim me Kryetarin, me qëllim të paraqitjes së shqetësimeve, kërkesave dhe propozimeve të qytetarëve të përfaqësuar nga këshillat lokale, por sipas tij takimi ende nuk është realizuar. Ai theksoi rëndësinë e rolit të këshillave të lagjeve dhe fshatrave si urë lidhëse ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve komunale, duke kërkuar që të respektohen obligimet e përcaktuara me rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin me këshillat lokale. Në emër të përfaqësuesve të këshillave lokale, ai kërkoi organizimin sa më të shpejtë të një takimi zyrtar dhe vendosjen e një komunikimi më të rregullt dhe të vazhdueshëm me komunën.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Falënderoi përfaqësuesin për shqetësimet e ngritura dhe theksoi gatishmërinë për bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm me qytetarët dhe përfaqësuesit e komuniteteve lokale. Ai sqaroi se angazhimet e shumta institucionale kanë ndikuar në pamundësinë për të realizuar të gjitha takimet në kohë, por kjo nuk paraqet mungesë vullneti për komunikim. Lidhur me kërkesën për takim, Kryetari bëri të ditur se, sipas kabinetit të tij, nuk është evidentuar një kërkesë e protokolluar zyrtare, duke theksuar rëndësinë e përdorimit të kanaleve institucionale të komunikimit. Kryetari vlerësoi angazhimin

vullnetar të kryetarëve të këshillave lokale dhe njoftoi se komuna ka paraparë kompensim simbolik për ta, si shenjë mirënjohjeje për kontributin e tyre në përfaqësimin e komuniteteve. Në përfundim, ai u shpreh i gatshëm që takimi me përfaqësuesit e këshillave lokale të organizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe kërkoi që koordinimi i terminit të bëhet përmes kabinetit të tij.

Përfaqësuesi i këshillave lokale nga Kopriva

Sqaroi se kërkesa për organizimin e një takimi të veçantë me përfaqësuesit e këshillave lokale ka për qëllim që të mos zgjaten takimet publike dhe t'u merret koha qytetarëve të tjerë. Ai theksoi se secili kryetar i fshatit apo lagjes përfaqëson komunitetin e tij dhe ka kërkesa e shqetësime të shumta për t'i adresuar, prandaj një takim i veçantë do të ishte më i përshtatshëm për diskutimin e çështjeve të komuniteteve.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

U pajtua me propozimin dhe shprehu gatishmërinë për organizimin e një takimi të veçantë me përfaqësuesit e këshillave lokale. Ai theksoi se caktimi i një takimi të tillë mund të bëhet në koordinim me përfaqësuesit dhe se komuna mbetet e hapur për këtë formë komunikimi.

Qytetari Remzi Uka, nga fshati Bajgorë,

Ngriti shqetësimin për gjendjen e rrugës në Lagjen Mch Uka dhe kërkoi informacione lidhur me kohën e realizimit të investimit në këtë segment rrugor. Ai theksoi se rruga është e dëmtuar dhe ka nevojë për ndërhyrje, duke kërkuar që Kryetari ta vizitojë nga afër gjendjen në terren. Gjithashtu, ai ngriti shqetësimin për rrugën drejt Lagjes "Uka" në Bajgorë, duke theksuar vështirësitë e qarkullimit për banorët, veçanërisht për personal me nevoja të veçanta dhe probleme shëndetësore që kanë nevojë për trajtime të rregullta mjekësore.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Falënderoi qytetarin për shqetësimet e ngritura dhe bëri të ditur se projekti për këtë segment rrugor është trajtuar dhe kontrata për realizimin e punimeve është nënshkruar. Ai njoftoi se fillimi i punimeve pritet të nisë së shpejti. Kryetari theksoi se zona e Bajgorës do të ketë vëmendje të veçantë gjatë këtij mandati dhe njoftoi se në planifikimet buxhetore janë paraparë edhe investime të tjera infrastrukturore, përfshirë segmente të reja rrugore. Ai bëri të ditur gjithashtu se është nënshkruar kontratë për një projekt të gjerë rrugor me vlerë mbi 3 milionë euro, që përfshin disa fshatra të Shalës, përfshirë edhe Lagjen "Uka" në Bajgorë. Në përfundim, Kryetari shprehu gatishmërinë që së bashku me ekipin komunal ta vizitojë zonën dhe të përcjellë nga afër realizimin e punimeve.

Qytetari Besim Shkupolli,

Falënderoi Kryetarin për mundësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe ngriti shqetësimin për gjendjen e një segmenti rrugor në zonën e Shalës dhe Bajgorës. Ai theksoi se bëhet fjalë për një rrugë me rëndësi për disa fshatra të kësaj zone, e cila ende nuk është asfaltuar në pjesën afër varrit të Beqirit. Ai kërkoi që ky segment rrugor të përfshihet në planifikimet komunale dhe në projektet e ardhshme infrastrukturore, duke vlerësuar rëndësinë e tij për banorët dhe qarkullimin në këtë zonë.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci,

Falënderoi qytetarin për shqetësimin e paraqitur dhe për besimin e shprehur. Ai theksoi se ky besim do të dëshmohet përmes punës, angazhimit dhe realizimit të projekteve në interes të qytetarëve, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim dhe adresimin e kërkesave të komunitetit.

Qytetari Ensar Lushtaku,

Ngriti çështjen e mungesës së infrastrukturës në Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, ku si operator ekonomik është përfitues i një parcele prej 50 ari që nga viti 2020. Ai sqaroi se, për shkak të mosshtrirjes së infrastrukturës në pjesën ku ndodhet parcela e tij, investimi nuk ka mundur të fillojë për rreth pesë vite. Ai kërkoi nga Komuna shqyrtimin e mundësisë për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme ose, nëse është e nevojshme, dislokimin e parcelës në një lokacion më të përshtatshëm, me qëllim të realizimit të investimit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci,

Falënderoi qytetarin për shqetësimin e paraqitur dhe theksoi rëndësinë e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjes së investimeve në Mitrovicë. Ai bëri të ditur se shumë operatorë ekonomikë kanë përfituar parcela komunale, por një pjesë e tyre ende nuk kanë filluar investimet brenda afateve të parapara. Kryetari njoftoi se do të themelohet një komision për rivlerësimin e të gjitha rasteve të parcelave të dhëna për investim, me qëllim që të identifikohen rastet ku nuk ka interes real për zhvillim dhe të krijohen mundësi për investitorë të tjerë. Lidhur me Zonën e Lirë Ekonomike në Frashër, ai sqaroi se projekti aktual i infrastrukturës përbën vetëm fazën e parë dhe se faza e ardhshme do të përfshijë

zhvillimin më të gjerë të zonës. Ai shprehu gatishmërinë që të shqyrtohen edhe mundësitë për ndërrim të parcelës në rastet kur kjo do të mundësonte realizimin e investimeve. Në përfundim, Kryetari theksoi se prioritet është që pronat komunale të shfrytëzohen për investime konkrete, krijim të vendeve të punës dhe zhvillim ekonomik të qytetit. Ai bëri të ditur se çështja e qytetarit do të trajtohet në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Qytetari Rafet Zcqiri,

Paraqiti tri çështje me interes për zhvillimin e qytetit: profilizimin e arsimit të mesëm, sigurinë e objekteve ndërtimore dhe menaxhimin e parkingjeve. Lidhur me profilizimin e arsimit të mesëm, ai theksoi nevojën që në Mitrovicë të rikthehen dhe zhvillohen profile profesionale si xehetaria, gjeologjia, metalurgjia dhe teknologjia, duke marrë parasysh potencialin ekonomik të zonës, veçanërisht Trepçën dhe sektorin industrial. Ai propozoi që të shqyrtohen edhe forma të mbështetjes për nxënësit përmes bursave, me qëllim tërheqjen e të rinjve në këto drejtime profesionale. Sa i përket sigurisë së objekteve ndërtimore dhe studimeve gjeomekanike, ai ngriti shqetësimin për përdorimin e analizave të njëjta gjeomekanike në zona të ndryshme të qytetit, pa marrë parasysh dallimet në përbërjen e tokës dhe karakteristikat e objekteve. Ai kërkoi që kjo çështje të analizohet nga drejtoritë përkatëse, duke theksuar rëndësinë e respektimit të standardeve të sigurisë sizmike. Në lidhje me menaxhimin e komunikacionit dhe parkingjeve, ai propozoi krijimin e një sistemi të organizuar të parkingjeve me pagesë, sipas modeleve të qyteteve të tjera, si dhe caktimin e lokacioneve të veçanta për automjetet e transportit publik dhe radiotaksitë.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci,

Falënderoi qytetarin për propozimet e paraqitura dhe u përgjigj sipas çështjeve të ngritura. Lidhur me parkingjet, Kryetari bëri të ditur se në të ardhmen e afërt parkingjet publike në Mitrovicë do të funksionojnë me pagesë. Ai theksoi se kjo masë synon menaxhim më efikas të hapësirave publike, krijimin e më shumë vendeve të lira për qytetarët dhe përmirësimin e qarkullimit në qytet. Sipas tij, sistemi synohet të jetë i digjitalizuar, duke mundur orientimin më të lehtë të qytetarëve përmes teknologjisë. Sa i përket urbanizmit dhe sigurisë së ndërtimeve, Kryetari theksoi se zhvillimi duhet të bëhet vetëm në përputhje me standardet teknike dhe ligjore. Ai bëri të ditur se gjatë kësaj periudhe janë duke u analizuar procedurat e dhënies së lejeve ndërtimore dhe se qëllimi është që i gjithë procesi, nga projekti fillestar deri te pranimi teknik i objektit, të jetë i bazuar në vlerësime profesionale dhe standarde të larta sigurie. Për çështjen e profilizimit të arsimit, Kryetari theksoi rëndësinë e arsimit dual dhe të përshtatjes së profileve arsimore me nevojat e tregut të punës dhe potencialet ekonomike të rajonit. Ai bëri të ditur se kjo fushë lidhet edhe me politikat e Ministrisë së Arsimit, por shprehu mbështetjen për zhvillimin e profileve që i përgjigjen nevojave të ekonomisë lokale.

Agesa Shkupolli, përfaqësuese e HANDIKOS-it,

Falënderoi për mundësinë e dhënë për paraqitjen e kërkesave dhe ngriti disa çështje që lidhen me përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara. Ajo kërkoi që të trajtohen: eliminimi i barrierave infrastrukturore (rampat, parkingjet, sinjalizimi dhe qasja në hapësirat publike); sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimet terapeutike dhe rehabilituese që ofrohen nga HANDIKOS; zbatimi i kuotës ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat. Po ashtu do t'ua dërgojmë shkresën e përgatitur me sfidat me të cilat po ballafaqohemi.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari falënderoi përfaqësuesen e HANDIKOS-it për kërkesat e paraqitura dhe theksoi se sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara do të jetë një nga prioritetet e Komunës. Ai bëri të ditur se, në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse, do të realizohen ndërhyrje infrastrukturore për përmirësimin e qasjes në trotuare, rrugë dhe objekte publike, me synim eliminimin e barrierave ekzistuese. Kryetari njoftoi se do të trajtohet edhe zbatimi i obligimeve ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në administratën komunale dhe institucione të tjera publike. Ai theksoi se do të sigurohet që projektet e ardhshme infrastrukturore të planifikohen duke përfshirë standardet e qasjes për personat me aftësi të kufizuara. Si shembull të ndërhyrjeve të realizuara, përmendi funksionalizimin e ashensorit për përdoruesit e karrocave dhe përshtatjen e hyrjes së objektit të Komunës për qasje më të lehtë.

Enes Rama, Kryetar i Asamblesë Komunale për të Drejtat e Fëmijëve,

Ngriti çështjen e mungesës së një zyrtari për të drejtat e fëmijëve në Komunën e Mitrovicës. Ai theksoi se, sipas Rregullores për funksionimin e Asamblesë Komunale për të Drejtat e Fëmijëve, komunat duhet të kenë një zyrtar përgjegjës për këtë fushë, i cili do të lehtësonte adresimin e kërkesave

dhe shqetësimeve të fëmijëve. Ai kërkoi të informohet për hapat që Komuna do të ndërmarrë për emërimin e këtij zyrtari dhe funksionalizimin e kësaj fushe.

Përgjigje – Kryetari i Komunës

Kryetari falënderoi për pyetjen dhe theksoi se nuk ka qenë në dijeni për mungesën e këtij zyrtari. Ai vlerësoi rëndësinë e takimeve me qytetarët për identifikimin e çështjeve që kërkojnë trajtim institucional. Ai u zotua se kjo çështje do të adresohet dhe se Komuna do të ndërmarrë hapat e nevojshëm, përmes sistemit të brendshëm ose procedurave të tjera ligjore, me qëllim sigurimin e një zyrtari për të drejtat e fëmijëve.

Replikë – Enes Rama

Theksoi rëndësinë që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt, duke bërë të ditur se mandati i Asamblesë Komunale për të Drejtat e Fëmijëve përfundon në muajin shtator dhe se një zyrtar përgjegjës do ta lehtësonte punën dhe organizimin e aktiviteteve të ardhshme.

Përgjigje – Kryetari i Komunës

Kryetari e ftoi Enes Ramën dhe anëtarët e Asamblesë për një takim të veçantë në kabinetin e tij, me qëllim diskutimin më të detajuar të kërkesave dhe çështjeve të ngritura. Ai bëri të ditur se stafi i kabinetit do të kontaktojë me ta për caktimin e takimit.

Ediart Brahimi, Nënkryetar i Asamblesë Komunale për të Drejtat e Fëmijëve,

Paraqiti disa kërkesa lidhur me përmirësimin e gjendjes në sektorin e arsimit dhe mbështetjen e fëmijëve. Ai kërkoi: angazhimin e psikologëve në shkolla për trajtimin e rasteve të dhunës, problemeve sociale dhe mbështetjen emocionale të nxënësve; rritjen e numrit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta; organizimin e trajnimeve për mësuesit për metoda më moderne të mësimit; përmirësimin e infrastrukturës shkollore, përfshirë rinovimin e objekteve, tualeteve, inventarit dhe rritjen e kapaciteteve në shkollat me mbingarkesë të nxënësve; funksionalizimin e pajisjeve teknologjike në shkolla, sigurimin e internetit, tabelave të mençura dhe kabineteve të informatikës; furnizimin e bibliotekave shkollore me libra të rinj; mbështetje më të madhe për aktivitete sportive, ekologjike, sociale dhe aktivitete të tjera për fëmijët dhe të rinjtë. Ai kërkoi gjithashtu një takim të veçantë me Kryetarin dhe institucionet përkatëse për diskutim më të detajuar të këtyre çështjeve.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari falënderoi Ediart Brahimin dhe anëtarët e Asamblesë për angazhimin dhe iniciativat e paraqitura, duke vlerësuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në adresimin e çështjeve publike. Ai theksoi se në sektorin e arsimit janë ndërmarrë hapa konkretë, duke përmendur si prioritet mbështetjen për fëmijët me nevoja të veçanta përmes angazhimit të asistentëve dhe psikologëve. Kryetari bëri të ditur se janë ridestinuuar 19 pozita në sektorin e arsimit, përfshirë 5 pozita për asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta. Ai njoftoi gjithashtu për investime në objekte shkollore dhe fusha sportive, si dhe për përmirësimin gradual të kushteve infrastrukturore në shkolla. Kryetari theksoi rëndësinë e depolitizimit të sistemit arsimor dhe përkushtimin e Komunës për ngritjen e cilësisë në arsim, duke shtuar se problemet në këtë sektor kërkojnë trajtim të vazhdueshëm dhe zgjidhje graduale gjatë mandatit. Në fund, ai i ftoi përfaqësuesit e Asamblesë për një takim të veçantë, me qëllim diskutimin më të hollësishëm të kërkesave dhe propozimeve të paraqitura.

Koment i qytetarit (nuk u prezantua),

Një qytetar përgëzoi Kryetarin për përmirësimet e realizuara në qytet, duke vlerësuar veçanërisht vendosjen e luleve dhe rregullimin e hapësirave publike dhe masat për orientimin më të mirë të lëvizjes së këmbësorëve.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari falënderoi qytetarin për vlerësimin dhe theksoi se komentet pozitive nga qytetarët janë një motivim për vazhdimin e punës. Ai sqaroi se vendosja e luleve dhe rregullimi i hapësirave publike nuk kanë vetëm karakter dekorativ, por edhe funksion praktik në orientimin e këmbësorëve drejt vendkalimeve të sigurta dhe në përmirësimin e sigurisë në komunikacion. Kryetari theksoi rëndësinë e respektimit të rregullave të komunikacionit dhe përdorimit të vendkalimeve të shënuara nga këmbësorët. Ai bëri të ditur se ndërhyrjet e realizuara këtë vit përbëjnë vetëm fazën fillestare dhe se në vitet e ardhshme do të vazhdohet me projekte të tjera për përmirësimin dhe zbukurimin e hapësirave publike.

Agim Ibishi, banor i Bajgorës (Lagjja Ibishi)

Ngriti shqetësimin lidhur me gjendjen e rrugës që lidh tri lagje në Bajgorë, duke kërkuar sqarime për realizimin e asfaltimit të plotë të këtij segmenti rrugor. Ai theksoi se rruga është rreth 3.2

kilometra e gjatë dhe se banorët nuk kanë informacione të qarta nëse projekti do të përfshijë të gjithë segmentin deri në fund të lagjes. Qytetari kërkoi informacione lidhur me: shtrirjen e projektit dhe nëse do të përfshihet i gjithë segmenti rrugor; afatin e realizimit të punimeve. Ai theksoi se mungesa e infrastrukturës rrugore ka vështirësuar jetën e banorëve dhe zhvillimin e aktiviteteve bujqësore e blegtorale në këtë zonë.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari falënderoi qytetarin për çështjen e ngritur dhe bëri të ditur se rruga në fjalë është pjesë e projektit të infrastrukturës në vlerë prej rreth 3 milionë euro. Ai sqaroi se, për të dhënë një përgjigje të saktë lidhur me shtrirjen e projektit dhe segmentet e përfshira, do të realizohet një vizitë në terren së bashku me Drejtorinë e Infrastrukturës, me qëllim verifikimin e gjendjes dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm. Kryetari theksoi se në planifikimin e investimeve infrastrukturore merren parasysh nevojat e banorëve, rëndësia e lokaliteteve dhe potenciali për zhvillim ekonomik, duke nënvizuar rëndësinë e mbështetjes së zonave me potencial në bujqësi dhe blegtori. Ai bëri të ditur se projekti i rrugës në drejtim të Lagjes Ibishi ka filluar, ndërsa për pjesët e tjera do të bëhet vlerësim në terren dhe do të ndërmerren veprimet përkatëse.

Marigona Rexha, përfaqësuese e organizatës Public Space,

Falënderoi për organizimin e takimit dhe vlerësoi mundësinë që qytetarët dhe organizatat të shprehin shqetësimet dhe propozimet e tyre. Ajo propozoi që, përveç takimeve obligative me qytetarët, të organizohen takime më të shpeshta me komunitetin, organizatat dhe grupet e interesit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet Komunës dhe shoqërisë civile. Ajo theksoi se organizata e saj ka kërkuar takim me Kryetarin që nga fillimi i mandatit, por ende nuk është realizuar, duke kërkuar një komunikim më të rregullt dhe më efektiv përmes kanaleve zyrtare. Ajo theksoi se organizatat lokale kanë kapacitete dhe gatishmëri për të kontribuar me ide, sugjerime dhe iniciativa për zhvillimin e qytetit, duke kërkuar që bashkëpunimi me Komunën të jetë më i vazhdueshëm dhe i strukturuar.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari falënderoi Marigona Rexhën për sugjerimet dhe theksoi se një qasje interaktive dhe bashkëpunimi me komunitetin sjell rezultate më të mira në qeverisje. Ai kërkoi që organizata të ridërgojë kërkesën për takim në kabinet, duke bërë të ditur se takimi do të organizohet. Gjithashtu, ai kërkoi që të përgatitet lista e drejtorive dhe fushave specifike për të cilat organizata dëshiron të diskutojë, në mënyrë që kabineti të koordinojë takimet me drejtorët përkatës. Kryetari theksoi se qeverisja nuk përfshin vetëm diskutimin, por edhe veprimin dhe realizimin e kërkesave konkrete. Ai sqaroi se për shkak të obligimeve institucionale dhe administrative nuk është gjithmonë e mundur të realizohen menjëherë të gjitha kërkesat për takime, por synimi është ruajtja e një balance ndërmjet komunikimit me qytetarët dhe zbatimit të detyrave institucionale. Ai inkurajoi organizatat që të paraqesin propozime dhe kërkesa konkrete sipas fushave, duke theksuar se drejtoritë përkatëse shpesh kanë ekspertizë më të drejtpërdrejtë për çështjet specifike. Në përfundim, Kryetari shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe theksoi se Komuna ka vullnet për t'i avancuar proceset në interes të qytetarëve.

Qytetare (nuk u prezantua dhe kërkoi të mos përmendet as shkolla, as persona konkretë për të cilët do të flas),

Ngriti shqetësim lidhur me praktikën e kerkimit të mjeteve financiare nga prindërit për renovimin dhe mirëmbajtjen e shkollës ku vijon mësimin fëmija i saj. Ajo theksoi se prindërit vazhdimisht janë kërkuar të kontribuojnë financiarisht, ndërsa njëkohësisht shkollat kanë buxhet të ndarë nga institucionet publike. Po ashtu shprehu shqetësim për rastin kur, pas dëmtimit të një dollapi në shkollë, drejtoria kishte marrë vendim që nxënësve të mos u shpërndareshin librezat deri në kompensimin e dëmit nga nxënësit/prindërit. Pyetja: A ka bazë ligjore që një shkollë të mbajë librezat e nxënësve për shkak të një dëmi material dhe a lejohet kerkimi i vazhdueshëm i mjeteve financiare nga prindërit për nevoja të shkollës, duke pasur parasysh se shkollat financohen edhe nga buxheti publik? Po ashtu ngriti shqetësimin lidhur me refuzimin e një kërkesë të paraqitur në Drejtorinë e Shëndetësisë, duke theksuar se është paciente me sëmundje tumorale dhe se gjendja e saj shëndetësore kërkon trajtim dhe mbështetje. Pyetja: Cilat janë kriteret dhe procedurat për shqyrtimin dhe miratimin ose refuzimin e kërkesave për mbështetje shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe kush është përgjegjës për vendimmarrjen në raste të tilla?

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari vlerësoi se shqetësimet e ngritura janë të rëndësishme dhe kërkoi që faktet dhe dëshmitë përkatëse t'u prezantohen drejtorëve përgjegjës, me qëllim ndërmarrjen e veprimeve konkrete.

Ai bëri të ditur se do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i gjendjes dhe se komuna është në komunikim me Ministrinë e Arsimit për të siguruar mbështetje për renovimin e objekteve shkollore, duke pasur parasysh kufizimet buxhetore. Kryetari theksoi rëndësinë e depolitizimit të sistemit arsimor dhe nevojën që institucionet arsimore të udhëhiqen nga profesionalizmi, meritokracia dhe cilësia. Ai udhëzoi qytetaren që për çështjet specifike të arsimit të vazhdojë komunikimin me Drejtorinë e Arsimit dhe drejtorët përkatës, të cilët do t'i shqyrtojnë kërkesat dhe do të ndërmarrin veprimet e nevojshme sipas mundësive ligjore.

Qytetari (nuk u prezantua),

Ngriti shqetësim lidhur me gjendjen e një familjareje me probleme shëndetësore, e cila aktualisht përballet me vështirësi financiare dhe ka nevojë për mbështetje për strehim ose mbulimin e shpenzimeve të qirasë. Ajo kërkoi të informohet nëse komuna ka mundësi ta ndihmojë në këtë rast.

Përgjigje – Kryetari i Komunës,

Kryetari bëri të ditur se raste të tilla adresohen përmes Qendrës për Punë Sociale dhe se në raste të caktuara komuna ka mbuluar edhe shpenzimet e qirasë për familje dhe persona në situata të veçanta. Ai njoftoi gjithashtu se janë duke u përgatitur programe të tjera që lidhen me strehimin dhe mbështetjen e familjeve në nevojë. Ai udhëzoi qytetarin që për çështjet specifike të shkojë dhe të konsultohet me Drejtorin e Mirëqenies Sociale.

Në përgjigje të diskutimeve të qytetarëve, Kryetari i Komunës adresoi çështjet e ngritura dhe ritheksoi angazhimin e komunës për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore në Bajgorë dhe Shalë, zhvillimin e zonave rurale dhe ekonomike, trajtimin e parcelave të pashfrytëzuara, krijimin e një komisioni për rishikimin e investimeve, si dhe avancimin e zhvillimit ekonomik dhe industrial të Komunës së Mitrovicës.

Përfundim

Kryetari i Komunës ka dhënë përgjigje dhe sqarime për secilën çështje të ngritur, duke u zotuar se kërkesat do të shqyrtohen dhe trajtohen në përputhje me kompetencat dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Takimi i Parë Publik i Kryetarit të Komunës me qytetarët për vitin 2026 përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes lokale në Mitrovicën e Jugut.

Mitrovicë 30.06.2026



Afërdita MAXHUNI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KRYETARI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 01-060/01-0034439/26 dt. 30.06.2026

Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes në Tubimin e parë publik për vitin 2026

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	Jylejman Emuni	30.06.2026	
2.	SEFIDE DELIBANO	30.06.2026	
3.	Imriza Shkupoll	30.06.2026	
4.	Ardiana Berisha	30.06.2026	
5.	Bedriye Mula	30.06.2026	
6.	Emirha Gashi	30.06.2026	
7.	Eres Rama	30.06.2026	
8.	Ajla Musa	30.06.2026	
9.	Beqir Shkupoll	30.06.2026	
10.	Faton Beqiri	30.06.2026	
11.	Burim Musa	30.06.2026	
12.	IVASER IVEZIRI	30.06.2026	
13.	TADIL ALICAJ	30.06.2026	
14.	VARIGONA REXHA	30.06.2026	
15.	Merita Dostani	30.06.2026	
16.	FESTIM SAMAJA	30.06.2026	
17.	Beqir Beqiri	30.06.2026	
18.	Gjergj Beqiri	30.06.2026	
19.	KFOR LMT SWISS	30.06.2026	
20.		30.06.2026	
21.		30.06.2026	
22.		30.06.2026	
23.		30.06.2026	
24.		30.06.2026	
25.		30.06.2026	
26.		30.06.2026	
27.		30.06.2026	
28.		30.06.2026	
29.		30.06.2026	
30.		30.06.2026	
31.		30.06.2026	
32.		30.06.2026	
33.		30.06.2026	
34.		30.06.2026	

Mitrovicë

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KRYETARI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 01-060/01-0034439/26 dt. 30.06.2026

Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes në Tubimin e parë publik për vitin 2026

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	JAKUP GASHI	30.06.2026	
2.	ISAK HAJRA	30.06.2026	
3.	Vahudin Baniq	30.06.2026	
4.	BEKIM BEK	30.06.2026	
5.	Enver Bajmiri	30.06.2026	
6.	Qemal Uka	30.06.2026	
7.	ENISAR LUSHTARI	30.06.2026	
8.	Hazir Bebrani	30.06.2026	
9.	Hajra Rex	30.06.2026	
10.		30.06.2026	
11.		30.06.2026	
12.		30.06.2026	
13.		30.06.2026	
14.		30.06.2026	
15.		30.06.2026	
16.		30.06.2026	
17.		30.06.2026	
18.		30.06.2026	
19.		30.06.2026	
20.		30.06.2026	
21.		30.06.2026	
22.		30.06.2026	
23.		30.06.2026	
24.		30.06.2026	
25.		30.06.2026	
26.		30.06.2026	
27.		30.06.2026	
28.		30.06.2026	
29.		30.06.2026	
30.		30.06.2026	
31.		30.06.2026	
32.		30.06.2026	
33.		30.06.2026	
34.		30.06.2026	

Mitrovicë

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KRYETARI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 01-060/01-0034439/26 dt. 30.06.2026

Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes në Tubimin e parë publik për vitin 2026

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	Agim Peçi	30.06.2026	
2.	Agim Peçi	30.06.2026	
3.		30.06.2026	
4.	Vllaz	30.06.2026	
5.		30.06.2026	
6.	Ruzhica, Thoma Shajri	30.06.2026	Ruzhica
7.	Shkurti, Kallmet	30.06.2026	Shkurti
8.	Fortuneli, Sotir	30.06.2026	S. Sotir
9.	Arben Vitaku	30.06.2026	Arben
10.	Haris Daku	30.06.2026	Haris
11.	Mustafa, Dali Peci	30.06.2026	
12.	Osman Simi	30.06.2026	Osman
13.	SADIK Begiri	30.06.2026	Sadik
14.	Agim Shkurti	30.06.2026	Agim
15.	Shkurti, Daku	30.06.2026	Shkurti
16.	Agim, Behrami	30.06.2026	Behrami
17.	Shkurti, Daku	30.06.2026	Shkurti
18.	Rexhep Rexhepi	30.06.2026	Rexhep
19.	Fati Begri	30.06.2026	Fati
20.		30.06.2026	
21.		30.06.2026	
22.		30.06.2026	
23.		30.06.2026	
24.		30.06.2026	
25.		30.06.2026	
26.		30.06.2026	
27.		30.06.2026	
28.		30.06.2026	
29.		30.06.2026	
30.		30.06.2026	
31.		30.06.2026	
32.		30.06.2026	
33.		30.06.2026	
34.		30.06.2026	

Mitrovicë

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI